

Autonomia Fiskale e Agjencive Publike



Punëtorja e NARUC/ERRA mbi Rregullimin e Ndërmarrjeve të Shërbimeve Publike në Ekonomi të Tregut

nga

George Young

Bordi për Shërbime Publike i Vermontit

16 prill 2008



Pasqyrë e prezantimeve

- ❖ Prezantimi i parë mbulon çështjen e autonomisë fiskale
 - Modelet aktuale që shfrytëzohen në Vermont e të cilat janë dizajnuar për të arritur këtë synim
- ❖ Prezantimi i dytë adreson strukturën e buxheteve të rregullatorëve, duke përdorur shembullin e Vermontit
- ❖ Prezantimi i fundit shtjellon proceset e rishikimit dhe miratimit të buxhetit



- ❖ Fondet adekuate janë të domosdoshme për rregullim efektiv
- ❖ Por ngjashëm të rëndësishme janë edhe stabiliteti dhe parashikueshmëria
 - Aktivitetet mund t'i adoptohen nivelit të buxhetit
 - Ndryshimi i nivelit buxhetor mund të shkaktojë pengesa të shquara



Financimi i Agjencive Rregullative

- ❖ Shumica e shteteve të SHBA-ve dhe Qeveria Federale financojnë aktivitetet rregullative si pjesë të buxhetit të përgjithshëm
- ❖ Mund të paraqet një dozë rreziku në raste të rënies së nivelit të tatimeve të mbledhura apo në rast të rritjes më të vogël se sa inflacioni, kur buxheti i rregullatorëve pëson rënie
- ❖ Mund të shënohet eksponim i limituar ndaj ndikimit politik
 - *Zakonisht, nga legjislativi dhe administrata kuptohet se ndryshimet e mëdha në buxhet mund të paraqesin lëkundje të theksuara.*
- ❖ Kjo rezulton me buxhete stabile



Dy mekanizma për financimin e aktiviteteve të BSHP

- ❖ Tatimi nga të hyrat bruto
- ❖ Ndërmarrjet për Efikasitet të Energjisë
 - Ndërmarrja është entitet i veçantë, i autorizuar me statut, me buxhet të përcaktuar nga Bordi
- ❖ BSHP gjithashtu menaxhon me fondin shtetëror për Shërbime Universale ngjashëm sikur edhe me fondin për Efikasitet të Energjisë



Përparësitë që sjell qasja Vermontit ndaj financimit

- ❖ Burimi i financimeve identifkohet ndaras
- ❖ Gjithashtu është mjaft stabil, pasi ndërlidhet me të ardhurat për shërbime publike
- ❖ Si rezultat, edhe buxheti është stabil, pasi që është relativisht i parashikueshëm
- ❖ Siç do të diskutojmë sa i përket rishikimit buxhetor, buxheti ende duhet të rishikohet nga Guvernatori dhe legjislatura



Tatimi në të hyrat(faturat) bruto

- ❖ Burim primar i financimit për buxhetin e BSHP
- ❖ Tatimi aplikohet ndaj bruto të hyrave(faturave) të kompanisë që i nënshtrohen rregullimit nga Bordi



Tatimi në të hyrat (faturat) bruto (vazhdim)

- ❖ 0.5% tatim në shërbimet e energjisë elektrike dhe telefonisë
- ❖ 0.3% tatim në shërbimin e gasit
- ❖ 0.5% tatim në televizion kabllovik
- ❖ 0.1% tatim në shërbimet e ujësjellësit dhe kompanive të tjera që i nënshtrohen rregullimit
- ❖ Vlerat më të ulëta për gaz/ujë reflektojnë dallimin në shtrirjen e



Tatimi në të hyrat (faturat) bruto (vazhdim)

- ❖ Tatimi gjeneron rreth \$6.3 në vit
- ❖ Shfrytëzohen për financim të BSHP dhe Departamentit për Shërbime Publike---
40% për BSHP dhe, 60% për Departamentin



*Të hyrat nga tatimi në faturat bruto, ndarë për industri - FY 2007
(Pjesa e BSHP nga këto të hyra është 40 përqind)*

Industria	Norma e tatimit të bruto faturave	Bruto të ardhurat operative	Tatimi i paguar në 2007 Për DSHP	Tatimi i paguar në 2007 Për BSHP	Përqindja e totalit të paguar për BSHP
Ener. Elektrike	0.005	\$723,131,156	\$2,169,394	\$1,446,263	57.33%
Telefon	0.005	255,935,350	1,101,219	734,146	29.10%
Kabllovike	0.005	118,088,207	354,078	236,052	9.36%
Gas	0.003	88,025,253	158,446	105,630	4.19%
Ujë	0.001	1,477,325	846	564	0.02%
Total		\$1,186,657,291	\$3,783,983	\$2,522,655	100.00%



AKTIVITETET E BORDIT PËR SHËRBIME PUBLIKE, PËR INDUSTRI - VF 2007

Industria	Lëndë të proceduara		Regjistrime lëndësh		Dëgjime		Vendime të lëshuara	
	No.	Pqnd. total	No.	Pqnd. total	No.	Pqnd. total	No.	Pqnd. total
En. Elektrike	135	63%	226	44%	136	81%	358	62%
Telefoni	59	27%	178	34%	14	8%	125	22%
Kabllovik	4	2%	84	16%	1	1%	29	5%
Gas	7	3%	24	5%	11	7%	53	9%
Ujë	11	5%	6	1%	5	3%	15	2%
Total	216	100%	518	100%	167	100%	580	100%



Kompanitë e Rregulluara në Vermont, për industri

Industria	FY 2002	FY 2003	FY 2004	FY 2005	FY 2006
En Elektrike	22	22	22	21	21
Telekomunikacion:					
Këmbim lokal	10	10	10	10	10
Clec/Rishitës/Celular	491	510	524	522	534
TV Kabllorik	21	20	20	20	20
Gas Natyral	1	1	1	1	1
Ujë	33	28	28	28	28
Total	578	591	605	602	614



Tatimi në të hyrat (faturat) bruto (vazhdim)

- ❖ Fondet janë të ndara nga fondet e përgjithshme të Shtetit (d.m.th. nga të hyrat nga tatimet normale)
- ❖ Pjesët e pashfrytëzuara të të hyrave nga tatimi në faturat bruto mbahen në një fond rezervë
- ❖ Fondi rezervë ofron një masë sigurie për vitet vijuese apo mbulon shpenzimet e papritura
 - Bordi dhe Departamenti mund të përdorin paratë nga fondi rezervë për t'i shtuar të hyrave nga faturat bruto



Autoriteti Bill-back

- ❖ Të hyrat nga tatimi në bruto fatura plotësohet nga **bill-backs**
- ❖ Bordi dhe Departamenti janë të autorizuar që të ngarkojnë ndërmarrjet e shërbimeve publike për shpenzimet e disa procedurave rregullative
- ❖ Më parë është shfrytëzuar kryesisht për shpenzimet për konsulencë, të cilat mund të jenë të larta në procedura më komplekse



Autoriteti Bill-Back (vazhdim)

- ❖ Edhe pse është i autorizuar që t'ia faturojë shpenzimet ndërmarrjes, Bordi nuk duhet domosdoshmërisht që të shpenzojë mjetet
- ❖ Ende është i detyruar të shpenzojë mjetet e lejuara nga legjislatura
- ❖ Bordi mund të kërkojë leje nga komisionet legjislative apo administrata për të shfrytëzuar një pjesë nga **bill-back** për të mbuluar kostot e konsulencës



Fondet speciale

- ❖ Bordi administron dy fonde speciale të cilat paraqesin një model të veçantë
- ❖ Fondin për Efikasitet të Energjisë
- ❖ Fondin për Shërbim Universal Telefonik
 - Linja e drejtpërdrejtë për telefoni
 - Shërbimi i relejit për persona me të meta në të folur/dëgjim
 - E911



Fondi për efikasitetin e energjisë

- ❖ Qëllimi: të sigurojë fonde për ndërmarrjen e masave për energji efektive kundrejt kostos
- ❖ Programet financohen përmes një pagese të caktuar në shërbimin e energjisë elektrike
- ❖ Programet e tilla të udhëhequra nga shërbimet përkatëse janë mes programeve më gjithëpërfshirëse në SHBA dhe pritet të eliminojnë rritjen e nivelit të shpenzimit të energjisë elektrike në Vermont



Fondi për efikasitetin e energjisë (vazhdim)

- ❖ Bordi ka autorizim që të përcaktojë nivelin e kësaj tarife
 - Në të kaluarën, programet i nënshtroheshin një kufizimi statutor
 - Ky kufizim ishte mes \$14 deri 17 milion në vit
- ❖ Para dy vitesh, legjislatura hoqi këtë kufizim
- ❖ Bordi tani mund të përcaktojë tarifën në nivel të cilin e vlerëson si të arsyeshëm



Fondi për efikasitet të energjisë (vazhdim)

- ❖ Tani arrin rreth \$30 milion në vit
- ❖ Për të siguruar një perspektivë, buxheti normal rregullator i Bordit është rreth \$2.5
 - Ky fond që menaxhohet tërësisht nga Bordi është 12 herë më i madh



Fondi për efikasitet të energjisë (vazhdim)

- ❖ Statuti specifikisht përcakton se fondi i përket paguesve, që do të thotë se ky fond mbetet i ndarë nga të ardhurat tjera tatimore dhe nga fondet tjera speciale
- ❖ Mbikëqyrja legislative dhe administrative e fondeve është e limituar
- ❖ Në vend të kësaj, norma e fondit bazohet në balancin mes normës së arsyeshme tatimore dhe nevojës për të pasur resurse që janë të efektshme kundrejt kostos që bartin



Fondi për shërbim universal

- ❖ Ngjashëm si me fondin për efikasitet energjetik, fondi për shërbime universale përcaktohet nga Bordi, jo legjislatura
- ❖ Fondi është i dizajnuar për të përkrahur një program të drejtpërdrejt telefonik dhe një shërbim releji për persona me të meta në të folur dhe dëgjim.
- ❖ Programet financohen përmes një tarife shtesë në shërbimin telefonik



Fondi për shërbim universal (vazhdim)

- ❖ Gjithashtu financon sistemin e *Enhanced 911*, edhe pse është thjeshtë një kalim i vlerës që përcaktohet nga legjislatura
- ❖ Bordi ka të drejtë diskrecioni që të përcaktojë tarifën, deri në vlerën prej 2% nga të ardhurat nga telefoni



Fondi për shërbim universal (vazhdim)

- ❖ Fondet e ndara i lejojnë Bordit fleksibilitet në përcaktimin e ngarkesave, në mënyrë që të sigurojnë të ardhurat e duhura
- ❖ Paratë mbesin të ndara nga fondi i të hyrave të përgjithshme, kështu që nuk ka eksponim ndaj presioneve politike
- ❖ Si fond i ndarë që është, Bordi mund t'i mundësojë kryerjen e balansimeve të caktuara pa frikë nga diversioni i parave



Konkluzion

- ❖ Buxheti relativisht stabil dhe i parashikueshëm është thelbësor për rregullatorët efektiv
- ❖ Burimet e ndara financuese, edhe nëse i nënshtrohen mbikëqyrjes, i ndihmojnë në arritjen e këtij caku